

MATERIALI MBËSHETËS JO-DETYRUES LIDHUR ME TEKNOLOGJINË: DOKUMENTIMI I AUDITIMIT KUR PËRDOREN MJETE DHE TEKNIKA TË AUTOMATIZUARA

Ky publikim është përparim nga Grupi i Punës së Teknologjisë (TWG) i Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë® (IAASB). Ai ka për qëllim të ndihmojë audituesit të kuptojnë sesi përdorimi i mjeteve dhe teknikave të automatizuara gjatë një angazhimi auditimi mund të ndikojë, ose jo, dokumentimin e audituesit në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit™ (SNA™) 230¹. Ky publikim nuk ndryshon ose çënon Standardin Ndërkombëtar mbi Kontrollin e Cilësisë (SNKC) 1 ose SNA-të, përmbajtjet e të cilave veçmas janë autoritare. Leximi i këtij publikimi nuk zëvendëson të lexuarit e SNKC 1 ose SNA-ve™.

Ky publikim ka për qëllim të ofrojë ndihmë praktike për praktikuesit për të kuptuar konsideratat e rëndësishme për dokumentimin e auditimit kur përdoren mjete dhe teknika të automatizuara. Shembujt janë dhënë vetëm për qëllime ilustruese.

Shënim për lexuesit

Të përfshira në këtë publikim janë referencat për projektet aktuale të IAASB-së, konkretisht projektet për të finalizuar:

- **Paraqitjen e draftit të Standardeve Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë (SNMC) 1 (Drafti — SNMC 1), Menaxhimi i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Informacioneve Financiare Historike dhe Angazhime të Tjera të Sigurisë dhe të Shërbimeve të Lidhura.**
- **Paraqitjen e draftit të SNA 220 (i rishikuar) (Drafti-220), Menaxhimi i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare.**

Disa nga materialet e këtij publikimi mbështeten në këto propozime. Të dy këto standarde janë targetuar për miratim nga IAASB në vitin 2020. Sapo të miratohen, TWG do ta përditësojë këtë publikim në mënyrën më të përshtatshme, duke marrë parasysh datën e hyrjes në fuqi të këtyre standardeve.

Seksioni I

Hyrje

Çfarë janë mjetet dhe teknikat e automatizuara?

Procedurat e auditimit mund të kryhen duke përdorur një numër mjeteve ose teknikash, të cilat mund të jenë manuale ose të automatizuara (dhe shpesh përfshijnë një kombinim të të dyjave). Praktikuesit mund të përdorin terma të ndryshëm në praktikë për të përshkruar mjetet ose teknikat që janë të automatizuara. Për shembull, zbatimi i procedurave analitike të automatizuara të dhënave gjatë procedurave të vlerësimit të rrezikut ndonjëherë quhet analizim i të dhënave.

Megjithëse termi "analizim i të dhënave" ndonjëherë përdoret për t'iu referuar mjeteve dhe teknikave të tilla, termi nuk ka një përcaktim ose përshkrim uniform. Ky term është shumë i kufizuar sepse nuk përfshin të gjitha teknologjitë e zhvilluara që përdoren gjatë hartimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit sot. Për më tepër, teknologjitë dhe aplikacionet e lidhura me auditimin do të vazhdojnë të evoluojnë, të tilla si aplikacionet e inteligjencës artificiale (IA), proceset e automatizimit të robotikës dhe përdorimi i dronëve. Prandaj, IAASB përdor termin më të gjerë, mjete dhe teknika të automatizuara (ATT).

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

Përdorimi i ATT dhe Dokumentimi i Auditimit

SNA 230¹ nuk bën dallime midis përdorimit të ATT dhe mjeteve dhe teknikave manuale në lidhje me kërkesat e dokumentimit të auditimit, por përdorimi i ATT-ve mund të rezultojë në konsiderata të ndryshme dokumentimi. Për shembull, natyra dhe qëllimet e dokumentimit të auditimit siç përcaktohen në paragrafët 2 dhe 3 të SNA 230 janë të njëjta, pavarësisht nëse ATT-të janë përdorur në kryerjen e angazhimit të auditimit dhe përfshijnë të mëposhtmet:

- Evidencën e bazës së audituesit për një përfundim rreth arritjes së objektivave të përgjithshme të audituesit.²
- Evidencën se auditimi është planifikuar dhe kryer në përputhje me SNA-të dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.
- Ndhmon grupin e angazhimit për të planifikuar dhe kryer auditimin.
- Ndhmon anëtarët e grupit të angazhimit që janë përgjegjës për mbikëqyrjen, të drejtojnë dhe mbikëqyrin punën e auditimit dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të rishikimit në përputhje me SNA 220³.
- Të bëjë të mundur që grupi i angazhimit të jetë përgjegjës për punën e tij.
- Mbajtjen e një regjistrimi për çështjet me rëndësi të vazhdueshme për auditimet e ardhshme.
- Të mundësojë kryerjen e rishikimeve dhe inspektimeve të kontrollit të cilësisë në përputhje me SNKC 1⁴ ose kërkesat kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese.⁵
- Të mundësojë kryerjen e inspektimeve të jashtme në përputhje me kërkesat ligjore, rregullatore ose kërkesat e tjera në fuqi.

Në mënyrë të njëjtë SNA 230 nuk bën dallime midis përdorimit të ATT ose mjeteve dhe teknikave manuale kur regjistron karakteristikat identifikuese të zërave të veçantë ose çështjeve të testuara.⁶

SNA 230 është i bazuar në parime dhe, prandaj, zbatohet pavarësisht nga natyra e mjetit ose teknikës që audituesi zbaton.

Kërkesat specifike të dokumentimit të SNA

Kur përdoret ATT në kryerjen e vlerësimit të rrezikut ose procedurave të mëtejshme të auditimit, audituesit i kërkohet të plotësojë kërkesat e dokumentimit të SNA 230 dhe të çdo SNA-je tjetër të rëndësishme⁷. Kjo përfshin kërkesa të tilla si ato të përcaktuara në paragrafin 38 të SNA 315 (i rishikuar 2019)⁸ dhe paragrafin 28 të SNA 330⁹. Shtojca e SNA 230 identifikon paragrafët e SNA-ve të tjera që përmbajnë kërkesa specifike të dokumentimit.

¹ SNA 230 *Dokumentimi i Auditimit*

² SNA 200 *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 11

³ SNA 220 *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafët 15-17

⁴ SNKC 1 *Kontrolli i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Informacioneve Financiare Historike dhe Angazhime të Tjera të Sigurisë dhe të Shërbimeve të Lidhura*, paragrafët 32-33, 35-38 dhe 48.

⁵ SNA 220 ekzistuese, paragrafi 2

⁶ Paragrafi A12 të SNA 230 ofron shembuj sesi audituesi mund të dokumentojë karakteristikat identifikuese të zërave specifik ose çështjeve të testuara.

⁷ Paragrafi A6 në SNA 230 shpjegon se SNA-të e tjera përmbajnë kërkesa specifike për dokumentimin që synojnë të qartësojnë zbatimin e SNA 230 në rrethanat e vecanta të këtyre SNA-ve të tjera.

⁸ SNA 315 (i rishikuar, 2019), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale*. Vini re që kërkesat e SNA 315 (i rishikuar, 2019) kanë hyrë në fuqi për periudhat që fillojnë në datë 15 dhjetor 2021 ose më pas.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

Ndërsa kërkesat e dokumentimit të SNA-ve janë të njëjta për mjetet dhe teknikat manuale dhe të automatizuara, ky publikim përshkruan rrethanat kur përdorimi i ATT-ve gjatë një angazhimi auditimi mund të rezultojë në konsiderata të ndryshme dokumentimi kur krahasohet me mjetet ose teknikat manuale.

Ky material është i organizuar si më poshtë:

- **Seksioni II:** Paragrafët e përzgjedhur nga SNA 230 dhe sesi përdorimi i ATT mund të ndikojë në dokumentimin e auditimit.
- **Seksioni III:** Konsiderata të veçanta.

Seksioni II

Paragrafët e përzgjedhur nga SNA 230 dhe sesi përdorimi i ATT-ve mund të ndikojë në dokumentimin e auditimit.

Rezultatet e procedurave të auditimit të kryera – SNA 230 paragrafi 8 (b)

8. Audituesi përgatit dokumentimin e auditimit në mënyrë të tillë që t'i mundësojë një audituesi me eksperiencë, por pa lidhje të mëparshme me auditimin në fjalë, të arrijë të kuptojë:

- a)
- b) Rezultatet e procedurave të auditimit (vendos theksin) dhe evidencën e auditimit të siguruar; dhe
- c) ...

Natyrë e ATT mund t'u sigurojë audituesve një mundësi për të shqyrtuar dhe analizuar grupe të mëdha të të dhënave. Në kontekstin e SNA 230 paragrafi 8 (b), kur përdoret ATT në analizimin e një grupi të plotë të dhënash, audituesit i kërkohet të dokumentojë rezultatet e analizës për grupin e të dhënave. Kjo mund të jetë mjaft e thjeshtë, për shembull, duke përdorur një vizualizim të rezultateve. Përndryshe, kjo mund të arrihet duke dokumentuar se për çdo zë të testuar është bërë analiza për të treguar këtë, për shembull:

- Transaksionet janë regjistruar brenda orarit normal të punës,
- Transaksionet lidhen me një numër unik të urdhrit të blerjes, ose
- Transaksionet janë miratuar nga e njëjta ID e përdoruesit.

Prandaj ndërsa kërkesat e dokumentimit nuk ndryshojnë për ATT, mund të ketë dokumentim të ndryshëm për shkak të natyrës së ndryshme të mjeteve dhe teknikave të përdorura.

Për shembull, në përcaktimin e mjaftueshmërisë së humbjeve të pritshme të kredisë të një entiteti për llogaritë e arkëtueshme, audituesi mund të përdorë ATT-në për të analizuar të gjithë grupin e të dhënave të llogarive të arkëtueshme të një entiteti për të gjeneruar një listë të tepricave të llogarive të arkëtueshme që plotësojnë kriteret e specifikuar (psh., tejkalojnë kufirin e kredisë, nuk ka aktivitete ri-pagimi, etj). Kur një analizë e tillë rezulton me zëra të shumtë për hetime të mëtejshme, natyra dhe shtrirja e dokumentimit të kërkuar mund të rritet në krahasim me situatën kur nëse audituesi ka zgjedhur të përdorë teknikat e modelit. Në dokumentimin e një analize të tillë,

⁹ SNA 330, Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

audituesi mund të përdorë ATT-në për të matur këto përjashtime dhe nëse është e nevojshme, hedh rezultatet e analizës në një format ose lloj dokumenti (p.sh. një fletë pune ose përpunues fjalësh) që është i përshtatshëm për t'u përfshirë në dosjen e angazhimit të audituesit.

Çështjet e rëndësishme që lindin gjatë auditimit - ISA 230 paragrafi 8 (c)

8. Audituesi përgatit dokumentimin e auditimit në mënyrë të atillë që bën të mundur që një auditues me eksperiencë, por pa lidhje të mëparshme me auditimin në fjalë, të arrijë të kuptojë:

- a) Natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në zbatim të SNA-ve dhe të kërkesave të tjera ligjore e rregullatore; (Ref: Para. A6-A7) (a)
- b) Rezultatet e procedurave të auditimit dhe evidencën e auditimit të siguruar; dhe (b)
- c) Çështjet e rëndësishme që kanë lindur gjatë auditimit dhe konkluzionet e arritura në lidhje me këto çështje dhe gjykimet profesionale të rëndësishme të bëra (vendoset theksi) për këto konkluzione. (Ref: Para. A8-A11)

A8. Vlerësimi i rëndësisë së një çështje kërkon një analizë objektive të fakteve e të rrethanave. Shembuj të çështjeve të konsiderueshme përfshijnë:

- Çështjet që çojnë në rreziqe të konsiderueshme (siç janë përshkruar në SNA 315 (i rishikuar, 2019)).
- Rezultatet e procedurave të auditimit (vendoset theksi) që tregojnë (a) se pasqyrat financiare mund të përmbajë anomali materiale, ose (b) për nevojën e rishikimit të vlerësimin të mëparshëm të audituesit lidhur me rreziqet e anomalive materiale dhe reagimin e tij ndaj këtyre rreziqeve.
- Rrethanat të cilat ja vështirësojnë audituesit zbatimin e procedurave të nevojshme të auditimit.
- Faktet e gjetura që mund të çojnë në një modifikim të raportit të audituesit ose përfshirjen e një paragrafi me Çështje të Theksuar në raportin e audituesit.

Zgjedhja për të kryer një procedurë përmes përdorimit të ATT ose duke e kryer procedurën manualisht nuk ndikon në *dokumentimin* e një çështje të rëndësishme, por përdorimi i teknikave dhe mjeteve të ndryshme, qoftë manuale apo ATT, mund të rezultojë në çështje të ndryshme të rëndësishme nëpërmjet identifikimit. Megjithatë, paragrafi 8 (c) i SNA 230 kërkon që audituesi të dokumentojë konkluzionet e arritura dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Kur përdoret ATT, natyra e “gjykimeve të rëndësishme profesionale të bëra” mund të jetë e ndryshme nga ushtrimi i gjykimin profesional gjatë kryerjes së mjeteve dhe teknikave manuale. Për shembull, konsideroni dy skenarët e mëposhtëm që lidhen me një llogaritje inventari të vështirë dhe shumë material:

- Skenari 1: Kryerja e llogaritjeve provë të inventarit dhe analizimi i rezultateve.
- Skenari 2: Kryerja e llogaritjeve provë të inventarit dhe analizimi i rezultateve duke përdorur ATT - siç janë ato të marra përmes përdorimit të një droni dhe IA që mundëson analizimin e imazheve.

Ndërsa të dy analizat mund të kërkojnë gjykim profesional, natyra e dokumentimit për të mbështetur “gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra” mund të jetë e ndryshme. Për shembull, dokumentimi i Skenarit 1 mund të mos përfshijë mënyrën sesi një anëtar i grupit të angazhimit është trajnuar për të “llogaritur” inventarin vizualisht (d.m.th., përfshihet gjykimi i ulët profesional). Megjithatë, dokumentimi i Skenarit 2 mund të ketë nevojë për përfshirjen e hapave të përdorur nga personeli në funksionimin e dronit për qëllime të llogaritjes së inventarit duke bërë të mundur që droni të vendoset në mënyrë të tillë që të sigurojë një pamje sa më të mirë të inventarit të llogaritur dhe sesi IA është përcaktuar në mënyrë më të përshtatshme për të analizuar pamjet e siguruar nga droni.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

Forma, Përmbajtja dhe Shtrirja e Dokumentimit të Auditimit – SNA 230, Paragrafi A2

Forma, përmbajtja dhe shtrirja e dokumentimit të auditimit varen nga faktorë të tillë si:

- Madhësia dhe kompleksiteti i entitetit.
- Natyra e procedurave të auditimit që duhen kryer.
- Rreziqet e identifikuar të anomalive materiale.
- Rëndësia e evidencës së auditimit të siguruar.
- Natyra dhe shtrirja e përjashtimeve të identifikuar.
- Nevoja për të dokumentuar një konkluzion ose bazën për konkluzionin, e cila nuk mund të përcaktohet lehtë nga dokumentimi i punës së kryer apo nga evidencia e auditimit të siguruar.
- Metodologjia dhe mjetet e auditimit të përdorura.

Dokumentimi i auditimit përshkruan procedurat që ka kryer audituesi dhe sesi audituesi ka arritur në përfundime përmes auditimit. Në kontekstin e përdorimit të ATT-së për të kryer procedurat e auditimit, aspektet e mëposhtme gjithashtu mund të jenë të përshtatshme, duke patur parasysh formën, përmbajtjen dhe shtrirjen e dokumentimit të auditimit:

- Emri i mjetit të automatizuar të përdorur dhe një përshkrim i burimit të të dhënave të përdorura në analizë. Mjeti i përdorur ose grupi i plotë i të dhënave orgjinale (p.sh., dosja, baza e të dhënave, etj.) zakonisht nuk mund të mbahen si dokumentim i auditimit.
- Detajet e të dhënave të siguruar (p.sh., letra e kërkesës së të dhënave), nxjerrja e të dhënave dhe procesi i dorëzimit si edhe procedurat e vlefshmërisë dhe rakordimit të kryera nga audituesi. Siç do të ishte rasti për mjetet dhe teknikat manuale, detajet e të dhënave të siguruar mund të përfshijnë mënyrën e përdorimit të të dhënave në procedurat e auditimit, duke përfshirë se si të dhënat janë vlerësuar nëse janë të sakta dhe të plota për qëllime të sigurimit të evidencës audituese të mjaftueshme.
- Nëse ATT lejon audituesin të “futet në thellësi” përmes informacionit që analizohet për të identifikuar zërat ose karakteristikat e pazakonta, dokumentimin rreth filtrave / segmenteve ku është zbatuar dhe rrugën ose procesin e të menduarit të ndjekur.
- Natyra e procedurave të kryera dhe vizualizimi i rezultuar ose tabela e përmbajtjes së analizës (mund të jetë si një raport i eksportuar ose një screenshot) së rëndësishme për procedurat që kryhen.
- Përfshirja e ofruesve të shërbimeve nga palët e treta për të kryer shërbimet të nxjerrjes së të dhënave dhe sesi të dhënat janë përcaktuar, nëse janë të sakta dhe të plota.

Përdorimi i përsëritjeve të ndryshme të filtrave (ATT) – SNA 230 Paragrafët A4 dhe A7

A4. Audituesi përjashton nga dokumentimi i auditimit, projekt fletët e punës dhe projekt pasqyrat financiare që janë zëvendësuar, shënimet që reflektojnë mendime të paplota apo paraprake, kopjet e mëparshme të dokumenteve, të cilat janë korrigjuar për gabime ortografike ose gabime të tjera dhe dokumentet e dubluara

...

A7. Dokumentimi i auditimit jep evidencë që auditimi është në përputhje me SNA-të. Por nuk është as e nevojshme dhe as praktike për audituesin që të dokumentojë çdo çështje të marrë në konsideratë, ose çdo gjykim profesional të bërë, në një auditim. Më tej, nuk është e nevojshme për audituesin të dokumentojë veças (si për shembull në një listë kontrolli) zbatimin ndaj çështjeve për të cilat është demonstruar përputhshmëria e tyre nga dokumentet e përfshira në dosjen e auditimit.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

Një nga karakteristikat unike të përdorimit të ATT është se përsëritjet e ndryshme të procedurave të kryera te të dhënat mund të shikohen. Për shembull, audituesi mund të hartojë dhe të kryejë disa përsëritje të procedurave nëpërmjet përdorimit të filtrave të ndryshme tek të dhënat përpara arritjes në një rezultat përfundimtar. Siç është përmendur në paragrafin A4 të SNA 230, projekt fletët e punës nuk duhet të përfshihen në dokumentimin e auditimit. Megjithatë, audituesi mund të zgjedhë përfshirjen e vizualizimeve të ndryshme, rezultateve të përdorimit të filtrave të ndryshme, ose përsëritjet e algoritmeve, ku sipas gjykimit të audituesit, këto ndihmojnë në të kuptuarit e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të kryera të auditimit dhe rezultateve të arritura.

Shpesh, përdorimi i ATT-së (p.sh. një analizë e të dhënave) për të kuptuar tepicën e një llogarie ose klasën e transaksioneve mund të vërtetohet nga përsëritjet pasardhëse të kësaj analize. Audituesi mund të mbajë dokumentimin e një përsëritje të hershme kur analiza e rezultateve të tij mund të mbështesë gjykimet profesionale të bëra në përcaktimin ose hartimin e analizës.

SEKSIONI III

Konsideratat e veçanta - Si mund të ndikojë miratimi i kompanisë për burime teknologjike, siç është ATT, në Dokumentimin e Audituesit

Mund të lindin pyetje rreth ndryshimeve në natyrën dhe shtrirjen e dokumentimit të audituesit kur përdoret ATT, të cilat janë miratuar nga kompania për t'i krahasuar me përdorimin e ATT-ve që nuk kanë qenë subjekt i një procesi miratimi formal nga kompania (p.sh., kur një grup angazhimi zhvillon zgjidhjet e tij softuerike, ndryshon ose rishikon algoritmet standarde të kompanisë për të arritur një objektiv testimi të caktuar). Në mënyrë të veçantë, a do të kërkohet nga grupi i angazhimit të dokumentohet ndonjë konsideratë në lidhje me nëse:

- ATT është të përshtatshme për të mundësuar performancën e vazhdueshme të angazhimeve të cilësisë: dhe
- Personeli është i kualifikuar ose ka eksperiencën e duhur në përdorimin e ATT?

Ndërsa IAASB nuk ka nxjerrë kërkesa ose udhëzime në lidhje me këtë temë, draftet e publikuar së fundmi Drafti-SNMC 1 (ED-ISQM 1) dhe Drafti-220 (ED-220, i rishikuar) adresojnë këtë çështje. Për shembull:

a) Drafti -SNMC 1 (ED-ISQM 1)

38. Kompania do të përcaktojë objektivat e mëposhtëm të cilësisë që adresojnë marrjen, zhvillimin, përdorimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe caktimin e duhur të burimeve, duke përfshirë burimet njerëzore, burimet teknologjike dhe burimet intelektuale në kohën e duhur për të mundësuar hartimin, implementimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë:

a) ...

e) Kompania merr ose zhvillon, implementon dhe mirëmban burimet e duhura teknologjike për të mundësuar funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës dhe kryerjen e angazhimeve. (Ref. Para. A124-A131)

A130. Kur implementoni një aplikacion IT-je, veçanërisht një aplikacion i përshtatur IT-je që është zhvilluar posaçërisht për kompaninë, është e nevojshme që kompania të përcaktojë që aplikacioni i IT funksionon në mënyrë të duhur. Ky përcaktim mund të përfshijë marrjen në konsideratë nëse:

- Inputet e të dhënave janë të përshtatshme dhe ruhet konfidencialiteti i të dhënave.
- Aplikacioni i IT funksionon ashtu siç është projektuar dhe arrin qëllimin për të cilin është krijuar.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

- Rezultatet e aplikacionit të IT-së arrijnë qëllimin për të cilin ato do të përdoren.
- Përcaktohet qartë sesi përdoruesve u kërkohet të bashkëveprojnë me dhe përdorin aplikacionin e IT dhe përdoruesit kanë ndihmën e duhur.
- Kontrollat e përgjithshme të IT të nevojshme për të mbështetur funksionimin e vazhdueshëm të aplikacionit të IT ashtu siç është projektuar janë të përshtatshme.

Kompania mund të ndalojë veçanërisht përdorimin e aplikacioneve të IT ose veçoritë e aplikacioneve të IT derisa të përcaktohet që ato funksionojnë në mënyrë të duhur dhe janë miratuar për përdorim nga kompania.

b) Drafti-220 (ED-220)

A57. Politikat ose procedurat e kompanisë mund të përcaktojnë konsiderata ose përgjegjësi të mëtijshme të kërkuara për grupin e angazhimit kur përdoret teknologjia e miratuar nga kompania për të kryer procedurat e auditimit dhe mund të kërkojë përfshirjen e individëve me aftësi ose ekspertizë të specializuar në vlerësimin ose analizimin e rezultatit.

A58. Politikat ose procedurat e kompanisë mund të ndalojnë veçanërisht përdorimin e burimeve të caktuara teknologjike (p.sh. software-i që nuk është miratuar ende për përdorim veçanërisht nga kompania) ose mund të përfshijnë kërkesat për të miratuar përdorimin e një burimi të ri teknologjik. Në disa rrethana, politikat ose procedurat e kompanisë mund të mos përkohet me përdorimin e një burimi teknologjik specifik (p.sh. një fletë pune e zhvilluar nga grupi i angazhimit ose i siguruar jashtë grupit të angazhimit ose kompanisë). Në këto rrethana, partneri i angazhimit mund të ushtrojë gjykimin profesional duke marrë në konsideratë nëse përdorimi i burimit në angazhimin e auditimit është i përshtatshëm në kontekstin e angazhimit, dhe nëse po, si do të përdoret burimi teknologjik. Faktorët që mund të merren në konsideratë në përcaktimin nëse një burimi teknologjik specifik, që nuk është miratuar për t'u përdorur posaçërisht nga kompania, është i përshtatshëm për t'u përdorur në angazhimin e auditimit mund të përfshijë nëse:

- Përdorimi i burimit teknologjik përputhet me politikat ose procedurat e kompanisë, duke përfshirë politikat ose procedurat që lidhen me trajtimin e të dhënave dhe sigurinë.
- Burimi teknologjik funksionon ashtu siç duhet.
- Personeli ka kompetencën dhe aftësitë e kërkuara për të përdorur burimin teknologjik.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

Kur kompania ka miratuar një ATT, dokumentimi i mëposhtëm mund të përfshihet në nivelin e firmës (dokumentimi që mbështet sistemin e menaxhimit të cilësisë së kompanisë) dhe si pasojë jo në nivelin e angazhimit:

- Politikat ose procedurat e përdorura nga kompania në përcaktimin nëse ATT është e përshtatshme (p.sh. ATT është e përshtatshme për qëllimet dhe përmbushjen e objektivit të saj), dhe
- Informacione që mbështesin miratimin e ATT.

Megjithatë, kur një ATT nuk është subjekt i një procesi formal miratimi nga kompania për t'u përdorur në të gjitha ose në angazhime të caktuara të auditimit, dokumentimi i konsideratave të grupit të angazhimit në përcaktimin nëse ATT është e përshtatshme për angazhimin, mund të përfshihet në dokumentimin e auditimit.

Praktikisht, shembujt e mëposhtëm tregojnë sesi përdorimi dhe miratimi i ATT mund të ndikojë dokumentimin në nivelin e kompanisë ose në nivelin e angazhimit:

Rrethanat që lidhen me përdorimin dhe miratimin e ATT	Marrja në konsideratë e dokumentimit
ATT është miratuar nga kompania ose është software i jashtëm i miratuar nga kompania (p.sh. një përdorim i markës pa e përshtatur).	Dokumentimi në lidhje me miratimin dhe përdorimin e ATT mund të përfshihet në nivelin e kompanisë.
ATT nuk është subjekt i një procesi formal miratimi në nivelin e kompanisë, por politikat ose procedurat e kompanisë përcaktojnë kërkesat nëse grupi i angazhimit përdor ATT-në.	Dokumentimi në lidhje me përdorimin e ATT mund të përfshihet në dokumentimin e angazhimit të auditimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në politikat ose procedurat e kompanisë.
ATT nuk është subjekt i një procesi formal rishikimi dhe politikat ose procedurat e kompanisë nuk përcaktojnë kërkesat nëse grupi i angazhimit përdor këtë ATT.	Dokumentimi i konsideratave të grupit të angazhimit në përcaktimin nëse ATT-ja është e përshtatshme për angazhimin mund të përfshihet në dokumentimin e angazhimit të auditimit. Për shembull, dokumentimi mund të përfshijë mënyrën sesi grupi i angazhimit ka përcaktuar që ATT të: <ul style="list-style-type: none">• Përdoret dhe sigurohet në përputhje me politikat ose procedurat e tjera përkatëse të kompanisë.• Funkcionon ashtu siç ishte parashikuar.• Përdoret nga personeli që ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për të përdorur ATT.

Rreth IAASB

Qëllimi i IAASB është t'i shërbejë interesit publik nëpërmjet auditimit me cilësi të lartë, sigurisë, standardeve të tjera të lidhura dhe duke lehtësuar konvergjencën e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të sigurisë, duke rritur cilësinë dhe qëndrueshmërinë e praktikës në të gjithë botën dhe duke forcuar besimin e publikut në profesionin global të auditimit dhe sigurisë.

IAASB harton standardet e auditimit dhe sigurisë, si dhe udhëzimet e përdorimit për të gjithë profesionistët kontabël nën një proces të përbashkët të hartimit të standardeve që përfshin Bordin e Mbikëqyrjes së Interesit Publik, i cili mbikëqyr veprimtaritë e IAASB dhe Grupin Këshillimor Konsultativ të IAASB, i cili siguron kontributin e interesit publik në zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve. Strukturat dhe proceset që mbështesin operacionet e IAASB asistohen nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC).

Strukturat dhe proceset që mbështesin operacionet e IAASB lehtësohen nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve[®] ose IFAC[®]. IAASB dhe IFAC nuk e pranojnë përgjegjësinë për humbjen e shkaktuar ndaj ndonjë personi që vepron ose nuk i përmbahet veprimit në përputhje me materialin në këtë botim, qoftë kjo një humbje e shkaktuar nga pakujdesia ose jo.

Të drejtat e autorit © Prill 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

“Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë”, “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, “Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë”, “Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit”, “Standardet Ndërkombëtare në Shërbimet e Lidhura”, “Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë”, “Shënimet e Praktikës së Auditimit Ndërkombëtar”, “IAASB”, “ISA”, “ISAE”, “ISRE”, “ISRS”, “ISQC”, “IAPN” dhe logoja e IAASB janë logo të markave të IFAC, ose markave të regjistruara dhe markave të shërbimit të IFAC në SHBA dhe vendet e tjera.

Për informacione mbi të drejtën e autorit, markën tregtare dhe autorizimet, kontaktoni në permissions@ifac.org.

Dokumentimi i Auditimit Kur Përdoren Mjete dhe Teknika të Automatizuara

“Materiali Mbështetës Jo-Detyrues Lidhur Me Teknologjinë: Dokumentimi I Auditimit Kur Përdoren Mjete Dhe Teknika Të Automatizuara”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Prill 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Materiali Mbështetës Jo-Detyrues Lidhur Me Teknologjinë: Dokumentimi I Auditimit Kur Përdoren Mjete Dhe Teknika Të Automatizuara” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Materiali Mbështetës Jo-Detyrues Lidhur Me Teknologjinë: Dokumentimi I Auditimit Kur Përdoren Mjete Dhe Teknika Të Automatizuara” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Non-Authoritative Support Material: Audit Documentation When Using Automated Tools and Techniques”

Kontaktoni Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.